

VENDIM

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË “RENEW” SH.P.K.

Sot, më datë 15/10/2025, në selinë e shoqërisë “RENEW” Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 28/10/2020, me numër unik identifikimi (NUIS) M02228017S, në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 1, Tiranë, Shqipëri (këtu e në vijim “Shoqëria”), u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Është i pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme:

- **Shoqëria “ARC” Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit në fuqi, me numër unik identifikimi (NUIS) K81728025F, me seli në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 1, Tiranë, Shqipëri, **në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, zotërues i 100% të kapitalit të Shoqërisë**, përfaqësuar në këtë mbledhje në bazë të Vendimit të Ortakut të Vetëm datë 15/10/2025 nga Administratori i saj **Z. Zenel Hysenbegasi**, shtetas shqiptar, atësia Namik, i datëlindjes 31/12/1979, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Panajot Pano”, Kompleksi “Lin Konstruksion”, Shk. 3, Apt. 4/1, Yzberisht, identifikuar me Letërnjoftim ID Nr. 034895788 dhe Nr. personal H91231047K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Meqënëse në mbledhje është i pranishëm Ortaku që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, mbledhja konsiderohet e vlefshme dhe vendimet e saj plotësisht të rregullta:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i raportit të audituesit ligjor lidhur me zmadhimin e kapitalit të regjistruar.
2. Miratimi i zmadhimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
3. Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë.
4. Të ndryshme.

MEQËNËSE:

- A. “RENEW” Sh.p.k. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me kapital të zotëruar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- B. Në përputhje me Nenin 6, paragrafi (6.1), të Statutit të Shoqërisë, kanë filluar procedurat për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, me burim huatë e dhena, perfshire interesat e



papaguara, deri ne daten 30/09/2025, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë datë 06/10/2025.

- C. Sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë datë 06/10/2025, shoqëria Albanian Audit Partners Sh.p.k., me NIPT L014050190 me seli në adresën Rr.Skender Luarasi, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori **Z. Dashnor Çarçani**, lindur më 20/12/1959, në Lushnje, banues në Tirane, Shqipëri, mbajtës i licensës së Audituesit Ligjor Nr. 122, datë 26/12/2000, është caktuar me detyrën e përgatitjes së raportit mbi zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- D. Në përputhje me Nenin 9, paragrafi 9.1, pika “h” të Statutit, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë merr vendimin për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- E. Janë plotësuar të gjitha kushtet për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë, e cila është thirrur dhe organizohet në përputhje me Statutin dhe Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (“Ligji Tregtar”).

Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar të zbatuar në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me rendin e ditës, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë,

VENDOSI

1. **Miratimin e Raportit** – Të miratojë Raportin për zmadhimin e kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë të hartuar nga audituesi ligjor Dashnor Çarçani.
2. **Miratimin e zmadhimit të kapitalit të regjistruar** - Të miratojë zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga vlera aktuale prej 100,000 (njëqind mijë) lekë në 58,548,429 (pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e dyzet e tetëmije e katërqind e njëzet e nëntë) lekë.
 - Të miratojë rregullisht ndryshimin e Statutit të Shoqërisë, në pjesën e kapitalit themeltar i cili riformulohet si më poshtë: Kapitali themeltar i shoqërisë nga 100,000 (njëqind mijë) lekë rritet edhe me 58,448,429 (pesëdhjetë e tetë milion e katërqind e dyzet e tetëmije e katërqind e njëzet e nëntë) lekë dhe bëhet 58,548,429 (pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e dyzet e tetëmije e katërqind e njëzet e nëntë) lekë.
 - Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë.
 - Ortaku i Vetëm zotëron kapitalin e Shoqërisë si në vijim:
 - Ortaku, Shoqëria “ARC” Sh.p.k., zotëron 1 kuotë, e barabartë me 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë me vlerë 58,548,429 (pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e dyzet e tetëmije e katërqind e njëzet e nëntë) lekë.



3. Të autorizojnë Administratorin e Shoqërisë, Znj. Ejona Shkurti në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin për llogari të Shoqërisë të çdo dokumenti të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi dhe në përgjithësi të kryejë të gjithë veprimet e duhura për kompletimin e tij dhe të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri në marrjen e ekstraktit përkatës që vërteton kryerjen e këtyre veprimeve për të cilat autorizohet.

Ortaku i Vetëm merr këtë vendim, duke mos patur çështje të tjera për shqyrtim në rendin e ditës.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

“RENEW” SH.P.K.

me Ortak të Vetëm

SHOQËRIA “ARC” SH.P.K.

Përfaqësuar nga Administratori:

Z. Zenel Hysenbegasi

Zenel Hysenbegasi



VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
“ARC” SH.P.K.

Sot, më datë 15/10/2025, Ortaku i Vetëm i shoqërisë “ARC” SH.P.K., me seli në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 1, Tiranë, Shqipëri, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) K81728025F (në vijim quajtur “Shoqëria”), **Z. Besnik Leskaj**, shtetas shqiptar, lindur më 30/06/1976, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.personal H60630112W, merr në shqyrtim dhe vendos për çështjet si më poshtë vijon:

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në mbledhjen që do të mbajë shoqëria “RENEW” Sh.p.k. në datën 15/10/2025, në të cilën Shoqëria është Ortak i Vetëm zotërues i 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.
2. Autorizimi i Administratorit të Shoqërisë për të marrë pjesë dhe për të marrë vendime në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k. në datën 15/10/2025.

Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar të zbatuar në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me rendin e ditës, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rendin e ditës, pjesëmarrjen dhe marrjen e vendimeve në mbledhjen që do të mbajë shoqëria “RENEW” Sh.p.k. në datën 15/10/2025, në të cilën Shoqëria është Ortak i Vetëm zotërues i 100% të kapitalit të kësaj shoqërie, si vijon:

“(i). Miratimi i raportit të audituesit ligjor lidhur me zmadhimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Renew” Sh.p.k.

(ii). Miratimi i zmadhimit të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Renew” Sh.p.k.

(iii). Ndryshimi i Statutit të shoqërisë “Renew” Sh.p.k.

(iv). Të tjera.”.

2. Të autorizojë Z. Zenel Hysenbegasi, Administrator i Shoqërisë, për të marrë pjesë për të diskutuar, për të marrë vendime dhe për të votuar *pro*, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “RENEW” Sh.p.k. që do të mbahet në datën 15/10/2025, me rend

dite çështjet në pikën (1) më sipër, për të nënshkruar procesverbalin dhe vendimin përkatës si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm në lidhje me sa më sipër.

Ortaku i Vetëm merr këtë vendim, duke mos patur çështje të tjera për shqyrtim në rendin e ditës.

ARC SH.P.K.
Z. Besnik LESKAJ
Ortak i Vetëm

Besnik Leskaj

